



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 16.06.2025
Numër Protokollit: 5051/2025

A.nr.684/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.684/2025 të datës 18.04.2025 të parashtruar nga ankuesi N.SH, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*transferim si rezultat i ristrukturimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.06.2025 mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet** si e bazuar ankesa me numër A.nr.684/2025 e datës 18.04.2025 e parashtruar nga ankuesi N.SH.
- II. Anulohet** Vendimi MMPHI-377/2025, i datës 28.03.2025, i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, ndërsa lëndë kthehet *në rishqyrtim* dhe *rivendosje* tek organi i njëjtë Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- III. Obligohet** Komisioni i Ristrukturimit për MMPHI, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, sikurse përcaktohet në piken **II** të dispozitivit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Nëpunësi civil, N.SH (*tani e tutje referuar: ankuesi*), me datë 18.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit MMPHI-377/2025, të datës 28.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministra e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje MMPHI), ndërsa kjo e fundit më datë 05.05.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2587/2025 të datës 18.04.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimin e datës 01.02.2012 të ankuesit; Vendimin me Nr.295 të datës 21.01.2025 për miratimin e planit për aktet nënligjore të MMPHI-së për vitin 2025; Vendimin MMPHI-377/2025, të datës 28.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB; Emailin e datës 07.04.2025 nga ankuesi për Q.B; Emailin e datës 08.04.2025 nga F.D për Q.B; Raportin e punës të datës 03.03.2025 të Komisionit të Ristrukturimit; Vërtetimin e marrëdhënies së punës i datës 18.04.2025; Konkursin me Nr. Reference: RN00017356 për pozitën Drejtor i Departamentit të Infrastrukturës Rrugore; Konkursin me Nr. Reference: RN00017352 për pozitën Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Rrugëve; Njoftimin për kandidatin fitues i datës 20.03.2025 për pozitën Drejtor i Departamentit të Mbrojtjes së Mjedisit; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.04.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 05.05.2025; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit të Rrugëve; Vendimin me Nr. 2392/2024 i datës 29.11.2024 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit në MMPHI; Diplomën me Nr. 35932396; Përshkrimin e punës për pozitën Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshëm dhe Teknologji informative, Drejtor i Departamentit për buxhet dhe Financa, Drejtor i Departamentit të Infrastrukturës Rrugore dhe Hekurudhore, Drejtor i Departamentit për Inspektim, Drejtor i Departamentit të Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Rrugëve, Drejtor i Departamentit të Planifikimi Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit, Drejtor i Departamentit të Shpronësimit të Pronës së Paluajtshme, Drejtor i Departamentit për transport të Përgjithshëm, Drejtor i Departamentit Ligjor, Drejtor i Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, Drejtor i Departamentit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore, Drejtor i Departamentit për Patentë Shofer dhe Automjete, Drejtor i Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore, Drejtor i Institutit të Planifikimit Hapësinor dhe Vendimin me numër protokolli 3678/2025 i datës 30.05.2025 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës së ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, ndërsa lënda duhet të kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosije* tek organi i njëjtë, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit, sipas Aktit të Emërimit të datës 01.02.2012 është e punësuar në pozitën *Drejtor i Departamentit të Automjeteve*, tashmë në MMPHI Tutje sipas Vendimit me Nr.073/2024 të datës 29.03.2024 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me ç'rast procesi i organizimit të MMPHI, është pasuar me shuarje të pozitave, ndryshime në emërtime të

pozitive përkatëse si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kriterëve të punës për pozita të caktuara.

Në kuadër të përgjegjësive ligjore, Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin me Nr.2392/2024, të datës 29.11.2024, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Ministrinë e Shëndetësisë, ku ky i fundit më datë 03.03.2025 ka miratuar Raportin përfundimtar lidhur me procesin e ristrukturimit në MMPHI. Bazuar në këtë raport, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në MPB, më datë 28.03.2025 ka nxjerr Vendim MMPHI-377/2025, me të cilin ankuesin e ka transferuar nga pozita Drejtor i Departamentit të Automjeteve në pozitën Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshëm në Agjencinë Pyjore të Kosovës në kuadër të ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit MMPHI-377/2025, të datës 28.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB, pretendon se MMPHI nuk na ka mbajtur të informuar lidhur me ndryshimet sipas rregullores së re. Edhe pse jam transferuar në këtë pozitë sipas vendimit të kontestuar ushtruesi i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës i'u është drejtuar Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, duke i kërkuar që ky institucion është në proces të sistematizimit të vendeve të punës dhe kjo pozitë nuk mund të konsiderohet e lirë. Komisioni i Ristrukturimit i MMPHI-së, në raportin e tij nuk ka përshkruar asnjë detaj lidhur me rastin tim përveç që ka theksuar se ka mbetur jashtë institucionit.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me të drejtën e tij të sistemimit për shkak të riorganizimit, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësi përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësi përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës...Po ashtu Kolegji ju referuar edhe Rregullores (QRK) NR. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë konkretisht dispozitave që rregullojnë çështjen konkrete.*

Kolegji i Këshillit, në shqyrtim të raportit përfundimtar të punës të Komisionit të Ristrukturimit të MMPHI-së të datës 03.03.2025, e më konkretisht me rastin e shqyrtimit të rastit të ankuesit, konstaton se Komisioni i Ristrukturimit në rastin e ankuesit nuk ka dhënë asnjë përshkrim të detajuar e i cili do të përbënte shkak ligjor për konstatimin e drejtë të gjendjes faktikë, sepse sipas këtij raporti nuk mund të pasqyrohet në mënyrë të drejtë se pozita e ankuesit a është shuar, a është ndërruar përshkrimi i pozitës dhe po ashtu nuk është përshkruar asnjë detaj nëse është bërë përpjekje që ankuesi të transferohet fillimisht brenda ministrisë ku ka punuar. Rrjedhimisht duke marr parasysh parimin e menaxhimit të zyrtarëve publikë, dhe parimeve që rregullon Ligji Nr. 05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në rastin konkret: Nenin 4 paragraf 1, përcakton: “*Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.*”, Neni 9 paragrafi 2, përcakton: *Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t’u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj.* Neni 11 paragrafi 1 dhe 2, përcakton: *1. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që mosdija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit. Organi publik, në veçanti, informon palën për të drejtat dhe detyrimet e saj në procedurën administrative, si dhe për pasojat juridike të veprimeve a mosveprimeve të saj gjatë kësaj procedure. 2. Organi publik, gjatë procedurës administrative, ndihmon që palët të mbrojnë dhe realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre juridike, sa më lehtë të jetë e mundur por pa cenuar të drejtat dhe interesat juridik të personave të tjerë,* andaj marr parasysh dispozitat e cekura më lartë, dhe ato të përcaktuar sipas nenit 8 paragrafi 1 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “*Menaxhimi i marrëdhënies së punës së nëpunëses/it civil, nëpunëses/it të shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it të artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknike dhe mbështetëse, bazohet në parimin e ligjshmërisë, integritetit, meritës, transparencës, profesionalizmit, paañesisë partiake dhe mosdiskriminimit.*”, në suazat e dispozitave ligjore të cekura si më lartë, Kolegji i Këshillit, vlerëson se në rastin konkret të ankuesit nuk janë zbatuar plotësisht dispozitat ligjore në fuqi, ngase pala ankuese nuk ka qenë e njoftuar për ndryshimet në pozitën e tij dhe për zhvillimin e procedurës para Komisionit të Ristrukturimit, andaj edhe pretendimi i palës ankuese se Komisioni i Ristrukturimit nuk ka pashkruar asnjë detaj lidhur me rastin tim përveç që ka theksuar se ka mbetur jashtë institucionit, është i bazuar.

Lidhur me vendimin e kundërshtuar me ankesë, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar ligjshmërinë e Vendimit MMPHI-377/2025, të datës 28.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, konstaton se ky vendim edhe përkundër faktit që është nxjerr si rezultat i propozimit bazuar në raportin e punës së Komisionit të Ristrukturimit, mirëpo në këtë fazë ndaj këtij vendimi ka reaguar edhe ushtrues i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjorë të Kosovës (*institucion ku ankuesi është transferuar*), karrshi këtij vendimi tek Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, përmes emailit të datës 08.04.2025, duke e njoftuar se *pozita ku është transferuar në këtë rast ankuesi nuk është e lirë, si jeni në dijeni Agjencia Pyjore e Kosovës ashtu edhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural...janë në procesin e sistematizimit të vendeve të punës dhe si e tillë kjo pozitë nuk mund të konsiderohet si pozitë e lirë për transferim. Vendimi është lëshuar pa aprovimin paraprak të Agjencisë Pyjore çka përbën shkelje të procedurave të brendshme institucionale dhe cenon funksionimin e rregullt të procesit të sistematizimit të pozitive. Pala e cila është subjekt i këtij vendimi ka parashtruar ankesë në KPMSHCK. Kërkojmë me mirëkuptim që ky vendim të anulohet, ndërsa pas procesit të sistematizimit të pozitive në Agjencinë Pyjore dhe Ministrinë Bujqësisë do të ju njoftojmë për çdo pozitë të lirë ekuivalente në përputhje me rregulloret dhe procedurat në fuqi. Kolegji i Këshillit, ka parasysh faktin e pakontestueshëm që sipas nenit 14 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) NR. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, përcakton: “1. DMZP për institucionet e administratës shtetërore apo NjMBNj për institucionet e tjera, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e marrjes së propozimit nga komisioni i ristrukturimit, vendos për transferimin e nëpunësit dhe njofton nëpunësin për vendimin”, andaj duke marr parasysh edhe kërkesën e ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, DMZP verifikon shkaqet e refuzimit të transferimit dhe mund të shfuqizojë vendimin nëse plotësohen kushtet e pamundësisë së transferimit dhe të vendosë për transferimin në një pozitë tjetër.*

Kolegji i Këshillit, marr parasysh konstatimet si më lartë, vlerëson se Komisioni i Ristrukturimit i MMPHI-së me rastin e nxjerrjes së raportit të punës së datës 03.03.2025, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e cekura më lartë, njëkohësisht edhe vendimi i kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimi MMPHI-377/2025, i datës 28.03.2025, i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB është akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme”, prandaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë lidhur me paligjshmërinë e aktit të kontestuar, dhe me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, e në mbështetje të nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit mori vendim të aprovoj si të bazuar ankesën e palës ankuese, të anuloi Vendimin MMPHI-377/2025 të datës 28.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB përmes të cilit ankuesi ishte transferuar në pozitën Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshëm në Agjencinë Pyjore të Kosovës, dhe rastin e ankuesit t’a kthehej në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni i Ristrukturimit i MMPHI, me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, duke ndjekur pikëpamjet e dhëna juridike si në këtë vendim.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, me numër A.nr.684/2025.

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit N.SH;
- Organit të punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm, Komisionit të Ristrukturimit dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MMPHI,
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-s